

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
AGJENCIONI KOSOVAR PËR PRONA, KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU , ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-230/15**

**Prishtinë,  
18 Prill 2018**

**Në çështjen ligjore të**

**R.M. B**

**Pala ankuese**

**Kundër**

**Askush**

**Palë përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Ragip Namani anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA16381), të datës 21 Tetor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 12 Prill 2018, merr këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga R. B, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës, me numrin KPA16381.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, i datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar, me numrin KPA16381.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 30 Tetor 2006, R. B.(në tekstin e mëtejme, pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën ka kërkuar kthimin e posedimit të ngastrës kadastrale nr. 415/1, me kulturë arë e klasit të pestë, në vendin e quajtur, “Utrina”, Komuna Kadastral Podujevë, e cila evidentohet në fletën poseduese numër 177 (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Pala Ankuese thekson ta ketë trashëguar pronën e kërkuar nga prindi i ti në bazë të vendimit për trashëgimi O.Nr.29/94. Pala Ankuese deklaron se posedimin e pronës së kërkuar, e ka humbur me 1 qershor 1999, dhe se prona është uzurpuar nga Shoqata e Veteranëve.
2. Së bashku me kërkesën kishte dorëzuar në AKP *mes tjerash* dokumentet vijuese;
  - Vendimin administrativ nr. 461-19/93, të datës 25 Tetor 1993 të lëshuar nga Komisioni për kthimin e pronave-Komuna Podujevë, me të cilin i kthehet posedimi dhe pronësia në ngastrën kadastrale numër 415 palës ankuese dhe vëllait të tij Ž.
  - Aktvendimin Trashëgimie Nr. 29/94, të datës 05 dhjetor 1994 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kurshumli –dega për Podujevë, me të cilin shpallën trashëgimtar djemtë e trashëgimlënësit, Z. dhe R. B nga ½, pjesë ideale të pronës së kërkuar,
  - Aktvendimin Plotësues të Trashëgimisë, nr.28/94, të datës 5 dhjetor 1994,
  - Fletën Poseduese nr. 177 të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë në Podujevë me 23 Mars 1995, ku figuron se prona e kërkuar është në emër të palës ankuese dhe vëllaut të tij B. Z., në bashkëpronësi nga ½ ,pjesë ideale.
  - Aktvendimin nr. 952-3-87/95, të datës 02 mars 1995, të lëshuar nga Enti Republikan i Gjeodezisë së R. Serbisë-shërbimi për kadastër dhe paluajstshmëri në Podujevë, me të cilin sipas Aktvendimit plotësues të Trashëgimisë nr.28/94, të Gjykatës Komunale në Kurshumli. lejohej ndryshimi i pronësisë në emër të bashkëpronarëve Z. dhe R.B.

- Fleta Poseduese nr. 176 e datës 18 Maj 2010 e lëshuar nga Kadastr i zhvendosur, në bazë të cilës Pala Ankuese është bashkëpronar me 1/2, pjesë ideale në pronën e kërkuar,
3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, kishte bërë njoftimin për kërkesën me datë 27 Qershor 2008 dhe 26 Maj 2014, ku ishte gjetur se prona e kërkuar ishte shndërruar në varrezë memorialë e administruar nga Komuna e Podujevës. Drejtorit të e Gjeodezisë dhe Pronës, së Komunën e Podujevës , z. A. L, i ishte dorëzuar njoftimi i cili e ka nënshkruar, pa pretenduar ndonjë të drejtë në pronën e kërkuar. I njëjti deklaroi se kjo pronë për varrezat memoriale është dhënë nga Qeveria e Kosovës në koordinim me Ministrinë e Ambientit të Komunës Podujevë dhe Kooperativës Bujqësore “Përparimi”, në fund ka deklaruar se prona është privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Me 1 Korrik 2010 njoftimi për kërkesën ishte publikuar në gazetën nr. 3 të AKP-së, po ashtu ishte shpërndarë në Gjykatën Komunale në Podujevë dhe Prishtinë, zyrën kadastrale ,në UNHCR zyra rajonale DRC etj.
  4. Askush nuk ka paraqitur përgjigje, ndaj kërkesës së publikuar.
  5. Sipas raportit të verifikimit të Sekretarisë të AKP-së, të datës, 22 Shtator 2014, është verifikuar negativisht Aktvendimi nr. 361-19/93 i datës 25 Tetor 1993, me të cilin komisioni i kthimit të pronave të K. Podujevë, i kishte kthyer palës ankuese dhe vëllait të tij ngastrën kadastrale nr. 415 (ky dokument nuk është gjet as në Serbi dhe as në Kosovë). Po ashtu Aktvendimi Kadastral, nr.952-3-87/95, i datës 2 mars 1995, ishte verifikuar negativisht, (nuk ishte gjetur as në Serbi as në Kosovë).
  6. Dokumentet e paraqitura nga pala ankuese si Vendimi mbi Trashëgimin O.nr.29/94, i datës 05 dhjetor 1994, si dhe shtojca e vendimit të njëjtë, O.nr.28/94 janë vlerësuar se nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar. Sipas raportit të verifikimit të datës 24 shkurt 2014 të AKP-së, në Kadastrin e Krushevcit, është verifikuar, Fleta poseduese Nr.177, Komuna me vërejtje se ka ardhur deri te ndërrimi i numrit të fletës poseduese nga nr. 177, në numër 176.
  7. Sekretaria ka gjetur se sipas Certifikatës për paluajtshmeri me numër.Ul.71712060-00073, lëshuar nga zyra kadastrale Podujevë, e datën 30 mars 2010 e cila paraqet pronën e kërkuar si pronë shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore.
  8. Pala Ankuese ishte kontaktuar me datë 20 gusht 2009, dhe ishte informuar për rezultatin negativ të verifikimit. Nga ai është kërkuar që të paraqes dëshmi shtesë për të dëshmuar pronësinë e tij por i njëjti nuk ka ofruar dëshmi shtesë gjer në kohën e referimit të lëndës për vendimmarrje.
  9. Me 21.08.2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit , me shkresën informuese i është përgjigje Sekretarisë së AKP-së, dhe konfirmon se pala ankuese ka ngritur padi për pronën e njëjtë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, dhe procedura është duke u zhvilluar me nr. Ref. C-III-14-0180. Nga viti 1996 deri 1999 ngastra e kërkuar ishte administruar nga KB “Besa”, ndërsa prej vitit 1999, ishte bartur nën administrim të *Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, tani të Privatizimit*, ndërsa nga Shtatori 2013, ndërmarrja shoqërore ka hyrë në procedurë të likuidimit.

10. Më 21 Tetor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/260/2014 (në tekstin e mëtejshëm: (Vendimi i KKPK-së), e ka hedhë poshtë kërkesën duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores së UNMIK, nr.2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e pa luajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe ato komerciale e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079, për shkak të faktit se në bazë të verifikimit nga sekretaria *ex officio*, kjo çështje binte jashtë juridiksionit të Komisionit, sipas arsyeve në arsyetimin e vendimit të saj në paragraf 39, nga shkak i ekzistimit të procesit gjyqësor në gjykatën kompetente, parashtruar nga kërkuesi i pronës së kërkuar para datës 16 Tetor 2006 ,për të konfirmuar të drejtën pronësore në pronën e kërkuar.
11. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës(në tekstin e më tejshëm pala ankuese), më datë 04 Mars 2014, i njëjti kishte paraqitur ankesë më 27 Mars 2015.

### **Pretendimet e palës ankuese**

12. Pala ankuese thekson se; Vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të rregullave procedurale, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe vërtetim jo të saktë dhe jo të plotë të gjendjes faktike të cilat shkelje janë të rëndësishme për vendosje lidhur me kërkesën për vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe kthimin e posedimit në pasurin bujqësore , e që nga kjo rezulton se Vendimi i KKPK është jo i drejtë dhe ligjor.
13. Pala ankuese tutje në ankesë kryesisht e përshkruan rrjedhën e procedurës sipas kërkesës së tij të ushtruar në KKPM , të drejtën në pronën e kërkuar në tërësi e bazon në dokumentet të cilat ja ka bashkangjitur kërkesës, duke i përshkruar faktet sipas këtyre dokumenteve, në bazë të cilave pretendon se është pronar legjitim i pronës së kërkuar të cilën për shkak të rrethanave të vitit 1998/99, nuk është në gjendje ta posedoj dhe shfrytëzoj lirisht, pretendon se prona e kërkuar pa bazë ligjore evidentohet tani në emër të Kooperativës “Besa”, nga Podujeva.
14. Pala ankuese në tërësi e mohon faktin se ka ushtruar padi në dhomën e veçantë të gjykatës supreme për ndonjë të drejtë pronësore, as lidhur me pronën e kërkuar, para datës 16 Tetor 2006, as pas kësaj date, ndërsa thekson se të drejtën në këtë pasuri e ka fituar në bazë të procedurave të ligjshme para vitit 1999.
15. Në fund pala ankese kërkon që Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vërtetimit të fakteve dhe provave, të nxjerrë vendim me të cilin e anulon vendimin e ankimuar të KKPM dhe lëndën ta kthej në ri procedurë ,ose të nxjerrë vendim me të cilin e aprovon kërkesën e z. B, për kthimin e posedimit të ngastrës lëndore. Po ashtu kërkon të lirohet nga shpenzimet gjyqësore për shkak të kushteve ekonomike sociale dhe shëndetësore të rënda.

### **Arsyetimi ligjor**

### **Pranueshmëria e ankesës**

16. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditë sikur që parashihet në nenin 12 .1 të Ligjit nr.03/L-079, andaj është e pranueshme.

### **Meritat e ankesës**

17. Gjykata Supreme, shqyrtoi Vendimin e ankimuar dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.03/L-006, konstaton se Vendimi KKPK-së, nuk është i përfshirë me asnjë lëshim thelbësor procedural, zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve ashtu si theksohet në ankesë. Prandaj, ankesa nuk mund të miratohet.
18. Sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parashihet se juridiksioni i Komisionit përjashtohet, nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën për pronën para 16 tetorit 2006, kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50.
19. Në bazë të shkresës informuese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nr.10199 dt. 21 gusht 2014, dërguar Agjencisë Kosovare të pronave sipas kërkesës së saj *ex officio*, kjo e fundit informohet se në lidhje me pronën e kërkuar ngastrën kadastrale 415/1, Zona Kadastrale Penuh, vërtetohet se kërkuesi-pretenduesi i kësaj prone R. B, ka ushtruar padi në Dhomën e Posaçme të gjykatës supreme, dhe procedura gjyqësore në lidhje me pronën e kërkuar është në zhvillim e sipër e cila evidentohet nën shenjë, C-III-14-0180. Po ashtu sipas kësaj informate theksohet se patundshmëria lëndore është administruar nga KB “Besa”, në periudhën 1996-1999, ndërsa kjo ndërmarrje i është nënshtruar procedurës së likuidimit prej 09.09.2013, ngastrë kadastrale 415/1, e administruar nga NSH-ja, tani administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, dhe kjo agjenci do të jetë pjesë e procedurës e cila do të zhvillohet në AKP, në lidhje me ngastrat kontestuese. Në fund të kësaj shkresë qëndron se Agjencia Kosovare e Pronave nuk ka juridiksion mbi pronën e ndërmarrjeve shoqërore, sipas dispozitave ligjore në fuqi, sepse kjo është kompetencë ekskluzive e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
20. Nga gjendja e elaboruar si në paragrafin paraprak sipas vlerësimit të kësaj gjykate është i drejtë dhe i ligjshëm vendimi ankimor i KKPK-ës, sipas të cilit është konkluduar se për shkak të mungesës së juridiksionit të këtij Komisioni kërkesa është hedhur poshtë. Prandaj procedimi i mëtejshëm sipas padisë së paditësit, lidhur me pronën e kërkuar të paraqitësit të kërkesës ,është në kuadër të juridiksionit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.
21. Shënimet e gjetura nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, të theksuara si më lartë, dhe nga shkresa informuese e Agjencisë Kosovare të privatizimit, konfirmohet se prona e kërkuar trajtohet si pronë shoqërore në emër të KB “Besa”, dhe si e tillë i ishte nënshtruar procesit të likuidimit. Nga kjo rezulton se juridiksioni bie ekskluzivisht mbi Dhomën e Posaçme të

Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c), dhe nenit 5.1 (a), të Rregullores së UNMIK, për Dhomën e Posaçme 2008/4, e amendamentuar me Ligjin nr. 04//L-033 , dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji përkundër pohimit të palës ankuese se nuk ka inicuar procedurë në Dhomën e Posaçme qartazi del se jurisdiksioni është ekskluzivisht përjashtues për AKP-në, dhe bie mbi Dhomën e Posaçme.

22. Prandaj në këtë rast konkret e në pajtim me nenin 11.4, nën (b), të Rregullores së Unmik-ut, e miratuar me Ligjin nr.03/L-079, për shkak të mungesës së sferës së juridiksionit ,kërkesa është hedhur poshtë si në vendimin e ankimuar dhe rrjedhimisht nuk është vendosur për meritat e çështjes që i referohen objektit të kërkesës.
23. Mbi faktet e cekura në paragrafët më lartë, Gjykata Supreme konkludon se vendimi i KKPK-së është i drejtë, i ligjshëm me të cilin janë dhënë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes. Vendimi ankimor nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të ligjit material dhe procedural ,sipas nenit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, andaj ankesa refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi ankimor i KPCC, vërtetohet si drejtë dhe i ligjshëm sipas nenit 13.3 (c), Rregullores së UNMIK-ut 2006/50,e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
24. Ky aktgjykim i nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtën e tij pran organit kompetent, apo gjykatës kompetente nëse ai e vlerëson me interes ligjor.

### **Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

**Beshir Islami, kryetar i kolegjit**

**Anna Bednarek , gjyqtar i EULEX-it**

**Ragip Namani, gjyqtar**

**Bjorn Olof Brautigam , referent i EULEX-it**